

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
"PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË
SHTETËRORE TË PYJEVE"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Ky projektligj ka për qëllim krijimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve "SHSHP sh.a.", si një ndërmarrje shtetërore e ngarkuar me zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve dhe zbatimi e politikave shtetërore dhe standardeve ndërkombëtare në këtë sektor si dhe krijimin dhe administrimin e fidanishteve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Nevoja për ndërmarrjen e kësaj reforme buron nga mangësitë strukturore të sistemit aktual apo sfida që lidhen me koordinimin institucional, kapacitetet e kufizuara teknike dhe financiare për zbatimin e politikave pyjore, si dhe nevoja për forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit.

Gjithashtu, vihet re mungesa e një planifikimi të integruar në nivel kombëtar dhe shfrytëzimi i pamjaftueshëm i potencialit ekonomik që ofrojnë pyjet shtetërore apo si dhe mungesa e një rrjeti të organizuar fidanishte shtetërore për mbështetjen e programeve të pyllëzimit dhe ripyllëzimit.

Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve synon forcimin e kapaciteteve institucionale dhe ekonomike për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit pyjor, përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional, rritjen e investimeve në pyje dhe fidanishte shtetërore, si dhe zhvillimin e mekanizmave ekonomike që lidhen me administrimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore. Veprimtaria e Shoqërisë do të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për pyjet, duke respektuar kompetencat e autoriteteve publike dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore."

Organet drejtuese të Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a., në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, janë Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve përcaktohen në

Relacion shpjegues për projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a."

përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe detajohen më tej në aktet nënligjore që do të miratohen në zbatim të këtij ligji.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2026 për Ministrinë e Mjedisit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve” paraqet një ndërhyrje të domosdoshme ligjore dhe institucionale, e cila synon përmirësimin rrënjësor të mënyrës së zhvillimit dhe mbrojtjes së pasurisë pyjore shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Nevoja për këtë ndërhyrje lidhet ngushtësisht me sfidat aktuale të sektorit pyjor, si dhe me domosdoshmërinë për të ndërtuar një model të qëndrueshëm, efikas dhe transparent të menaxhimit të këtyre burimeve natyrore.

Një nga përparësitë kryesore të projektaktit qëndron në krijimin e një strukture të specializuar dhe përmes themelimit të Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve si një shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, synohet rritja e eficiencës në menaxhim, duke siguruar ndarje të qartë të përgjegjësisë dhe përmirësim të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Ky model organizimi mundëson gjithashtu aplikimin e praktikave moderne të menaxhimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat kombëtare në fushën e pyjeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të tyre.

Projektligji kontribuon në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë publike, përmes parashikimit të mekanizmave të detyrueshëm të raportimit, auditimit dhe publikimit të informacionit. Kjo krijon kushte për një administrim më të hapur dhe më të kontrollueshëm të pasurisë publike, duke rritur besimin e publikut dhe të aktorëve të interesuar. Njëkohësisht, orientimi i shoqërisë drejt një modeli me parime tregtare, por me objektiva publike, krijon mundësi reale për gjenerimin e të ardhurave, duke kontribuar në ekonominë kombëtare përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore dhe zhvillimit të aktiviteteve ekonomike të lidhura me to si dhe ngritjen e mekanizmave shtetërorë në

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

funksion të zhvillimit të këtij sektori nëpërmjet krijimit dhe administrimit të fidanishteve shtetërore, të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në pyllëzimet dhe ripyllëzimet e ekosistemeve të dëmtuara apo për rritjen e sipërfaqeve të fondit pyjor .

Nga ana tjetër, projektakti adreson një sërë problematikash të evidentuara në funksionimin aktual të sektorit pyjor. Ndarja e funksioneve ndërmjet institucioneve të ndryshme ka evidencuar nevojën për forcimin e mekanizmave të koordinimit, monitorimit dhe mbështetjes teknike në nivel kombëtar. Gjithashtu, mungesa e fidanishteve shtetërore që të mundësojnë rritjen e bimësisë pyjore në vaërsi të tipologjisë së nevojshme apo mungesa e një strukture të dedikuar me kapacitete të mjaftueshme për monitorim, inventarizim dhe planifikim afatgjatë ka kufizuar mundësinë për ndërhyrje të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në këtë sektor. Në këtë kontekst, projektligji synon të kapërcejë këto mangësi përmes konsolidimit të funksioneve, ngritjes së mekanizmave të nevojshëm si dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Krijimi i Shoqërisë nuk sjell transferim të kompetencave të njësisë të vetëqeverisjes vendore në fushën e administrimit dhe menaxhimit të fondit pyjor. Veprimtaria e saj ushtrohet në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjeve të parashikuara në projektligj."

Një tjetër problematikë e rëndësishme që synohet të zgjidhet është shfrytëzimi i pakontrolluar dhe, në disa raste, informal i burimeve pyjore, i cili ka çuar në degradim të ekosistemeve dhe humbje të vlerave natyrore. Mungesa e një qasjeje të strukturuar ekonomike ka kufizuar gjithashtu potencialin e sektorit për të gjeneruar të ardhura dhe për të kontribuar në zhvillimin rural. Përmes këtij projektligji, synohet krijimi i një modeli të ri menaxhimi, i cili kombinon mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht sektorin e pyjeve me zhvillimin ekonomik, duke garantuar një përdorim të balancuar dhe të qëndrueshëm të burimeve pyjore.

Efektet e pritshme nga miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji janë të shumanshme. Në planin institucional, pritet një përmirësim i ndjeshëm i menaxhimit të fondit pyjor, përmes një planifikimi më të mirë dhe kontrolli më efektiv të aktiviteteve në terren. Në aspektin ekonomik, parashikohet rritje e të ardhurave për buxhetin e shtetit, si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve tregtare të lidhura me pyjet dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të tyre. Në planin mjedisor, pritet reduktim i aktiviteteve të paligjshme, përmirësim i biodiversitetit dhe

rritje e sipërfaqeve të pyllëzuara, nëpërmjet programeve të ripyllëzimit dhe rehabilitimit.

Gjithashtu, projektligji pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin rural, duke krijuar mundësi të reja punësimi dhe duke nxitur aktivitete ekonomike në zonat pyjore. Rritja e transparencës dhe aksesit në informacion do të kontribuojë në forcimin e besimit publik dhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Në një plan më të gjerë, ky projektligj ndihmon në përafrimin e legjislacionit dhe praktikave të vendit me standardet e Bashkimit Evropian dhe angazhimet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të burimeve natyrore.

Në përfundim, projektligji përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sektorit pyjor në Shqipëri, i bazuar kryesisht në modelin Austriak, duke krijuar bazat për një menaxhim të qëndrueshëm, efikas dhe transparent të pasurisë pyjore shtetërore, në funksion të interesit publik dhe zhvillimit afatgjatë të vendit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, në harmonizim me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar të ligjit nr. 39/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar. Projektligji po ashtu, është hartuar në përputhje me *acquis* komunitar të Bashkimit Evropian, veçanërisht me kërkesat e Kapitullit 27 (Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike). Modeli i propozuar, i cili është bazuar kryesisht në modelin Austriak të menaxhimit të pyjeve, parashikon:

- i. Forcimin e kapacitetit institucional për zbatimin e direktivave europiane të mjedisit;
- ii. Adresimin e mangësive të identifikuara në raportet e progresit të BE-së;
- iii. Promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- iv. Mbështetjen e objektivave të Paktit të Gjelbër Evropian (European Green Deal).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

Ky projektligj nuk përafron me Acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është strukturuar në 5 Krerë, që i përkasin 20 nene. Struktura e projektligjit është ndërtuar në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri me ligjin nr. 57/2020 'Për pyjet', ligjin nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore' dhe ligjin nr. 9901/2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare', duke garantuar respektimin e kompetencave të autoriteteve publike dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe funksionimin e Shoqërisë sipas parimeve të qeverisjes së mirë korporative."

Konkretisht:

Kreu i Parë, parashikon rregulla të përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e kësaj shoqërie. Konkretisht:

Neni 1, i cili parashikon objektin e ligjit, i cili konsiston në krijimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Neni 2, përcakton në mënyrë të qartë objektivat e shoqërisë që konsistojnë ndër të tjera në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve, në përputhje me legjislacion sektorial, mbrojtjen dhe rehabilitimin ekosistemeve pyjore, krijimin dhe administrimin e fidanishteve shtetërore etj.

Neni 3, përcakton në mënyrë të qartë parimet e përgjithshme ku mbështetet funksionimi i kësaj shoqërie, ku vlen të theksohet respektimi i parimit të autonomisë vendore dhe bashkëpunimit me njësitë e vetqeverisjes vendore për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në këtë sektor, parimi i ekonomisë së tregut dhe realizimin e objektivave me interes publik në fushën e mjedisit dhe të pyjeve, si komponent kryesor i mjedisit, parimi i zbatimit me efektivitet, eficiencë, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave si dhe parimi i zbatimit të procedurave transparente, të thjeshta dhe të kontrollueshme.

Neni 4, parashikon statusin juridik të shoqërisë, si një shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si aksionar si dhe selinë qendrore të shoqërisë dhe mundësinë e krijimit të degëve dhe njësive operative në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5, përcakton funksione kryesore të shoqërisë dhe parashikimet e këtij neni janë në përputhje me Ligjislacionin në fuqi për pyjet dhe legjislacionin në fuqi për pushtetin vendor, pasi parashikohet shprehimisht që Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj pa cenuar kompetencat e autoriteteve publike përgjegjëse dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe kjo përbën një garanci të rëndësishme

Relacion shpjegues për projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a."

juridike për respektimin e kuadrit ekzistues të administrimit dhe menaxhimit të fondit pyjor. Gjithashtu, funksionet e përcaktuara në pikën 2 janë në përputhje me objektin dhe natyrën juridike të një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror dhe, në parim, nuk krijojnë mbivendosje të drejtpërdrejtë me kompetencat e institucioneve publike apo të njësive të vetëqeverisjes vendore, për sa kohë që ushtrohen në përputhje me legjislacionin sektorial dhe aktet e autoriteteve kompetente. Raporti i Shoqërisë me fondin pyjor në administrim të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe kushtet e ushtrimit të veprimtarive në këto sipërfaqe rregullohet në mënyrë të qartë në nenin 8 të projektligjit, që rregullon bashkëpunimin me bashkitë dhe kjo forcon sigurinë juridike të projektligjit dhe eliminon rrezikun e konflikteve kompetenciave gjatë zbatimit të tij.

Neni 6, parashikon burimet e financimit të shoqërisë si dhe përcaktohet që detyrimet financiare për shlyerjen e detyrimeve financiare është detyrim i shoqërisë.

Neni 7 i projektligjit parashikon krijimin e fondit të veçantë, si fond i brendshëm i Shoqërisë, i destinuar për financimin e veprimtarive në fushën e mbrojtjes, rehabilitimit, ripyllëzimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të fondit pyjor. Ky mekanizëm është në përputhje me parimet e organizimit dhe funksionimit të shoqërive aksionare sipas legjislacionit në fuqi.

Kreu II që përfshin nenet 8 dhe 9 parashikojnë bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe atë qendror e rajonal. Vlen të theksohet se neni 8 parashikon shprehimisht mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjes e bashkëpunimit midis shoqërisë dhe bashkive përkatëse, marrëveshje të cilat duhet të miratohen nga Këshillat Bashkiakë respektivë, duke zbatuar të gjitha parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore. Shoqëria nuk fiton të drejta administrimi apo përdorimi mbi fondin pyjor në pronësi ose administrim të njësive të vetëqeverisjes vendore, përveç rasteve kur kjo realizohet në bazë të marrëveshjeve të posaçme sipas legjislacionit në fuqi.

Riformulimi i këtij parashikimi është në përputhje me parimin kushtetues dhe ligjor të autonomisë vendore pasi, bashkëpunimi ndërmjet Shoqërisë dhe bashkive është vullnetar dhe jo i detyrueshëm, nuk imponohen detyrime të njëanshme ndaj bashkive, Këshilli bashkiak ruan kompetencën vendimmarrëse për miratimin e marrëveshjeve dhe mbi të gjitha respektohet parimi që bashkitë ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur.

Gjithashtu ky parashikim është në harmonizim edhe me ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, i cili njeh kompetenca të njësive të vetëqeverisjes vendore mbi fondin pyjor që kanë në pronësi dhe e administrojnë atë si dhe lejon

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

bashkëpunimin vetëm nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme, të lidhura mes bashkive dhe shoqërisë, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Pra në asnjë rast projektligji nuk parashikon prekjen e kompetencave të pushtetit vendor, por përkundrazi kontribuon në mbështetje të pushtetit vendor për realizimin e objektivave dhe menaxhimit të qëndrueshëm të sektorit të pyjeve. Ndërkohë neni 9 parashikon bashkëpunimin e SHPP sh.a edhe me institucionet në nivel qendror, akademik e kërkimor si dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e pyjeve.

Kreu III, parashikon strukturën organizative të SHPP si sh.a e cila është në harmonizim me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare. Konkretisht:

Neni 10 parashikon 3 organe drejtuese si Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori. Organizimi i brendshëm i organeve drejtuese, kompetencat dhe mënyra e funksionimit të shoqërisë përcaktohen në statutin e shoqërisë, i cili miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 11 rregullon rolin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit si organi më i lartë vendimmarrës dhe kompetencat e saj.

Neni 12 dhe 13 përcakton përbërjen dhe funksionet e Këshillit Mbikëqyrës, i cili ushtron drejtimin strategjik dhe mbikëqyrjen e shoqërisë si dhe kompetencat e këtij këshilli, të cilat janë në harmonizim me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

Neni 14 dhe 15 parashikon rolin e Administratorit si përfaqësues ligjor i shoqërisë dhe përgjegjësitë e tij kryesore.

Neni 16 parashikon rregulla për administratën e SHPP sh.a

Kreu IV parashikon rregulla për kontabilitetin dhe auditimin e pasqyrave financiare dhe është strukturuar me 2 nene, ku neni 17 parashikon rregulla për kontabilitetin dhe neni 18 për auditimin e pasqyrave financiare. Të dyja këto nene janë në harmonizim me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

Kreu V përmban dispozitën kalimtare për krijimin dhe funksionimin e SHPP sh.a dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohet Ministria e Mjedisit.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

Projektligji i propozuar është hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe është përcjellë për mendim, nëpërmjet sistemit e-akte: Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Gjithashtu projektligji iu përcoll për mendim Këshillit Konsultativ të Pushtetit Qendror me atë të Vetqeverisjes Vendore.

Ministri Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, janë shprehur parimisht dakord.

Ministria e Drejtësisë është shprehur dakord me vërejtje, duke sjell në vëmendje se në përputhje me ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, një nga institucionet përgjegjëse për pyjet është Agjencia Shtetërore Përgjegjëse për Pyjet, e ngritur si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit, që ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumëfunksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare. Detyrat e kësaj agjencie janë të parashikuara nga ligji, ndërsa organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve rregullohet nga vendimi nr.570, datë 17.07.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i ndryshuar.

Për sa kohë ligji nr.57/2020, i ndryshuar, ka parashikuar një organ përgjegjës që kryen funksionet që sipas projektligjit të propozuar përbëjnë objektin e veprimtarisë së Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, vlerësojmë të domosdoshme ndërmarrjen e nismës për ndryshimin e ligjit nr.57/2020, i ndryshuar dhe argumentimin në mënyrë të detajuar dhe shteruese mbi shkaqet e zëvendësimit të një organi shtetëror me një shoqëri aksionare shtetërore.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se projektligji është ripunuar tërësisht duke shmangur mbivendosjen e funksioneve të SHPP sh.a me detyrat e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe duke qartësuar objektivat dhe funksionet kryesore që ka kjo Shoqëri në funksion të krijimit dhe menaxhimit të fidanishteve shtetërore me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve nëpërmjet pyllëzimeve, ripyllëzimeve rehabilitimit të sipërfaqëve të dëmtuara apo shtimin e sipërfaqeve të reja. Ndërkohë që Agjencia si detyra funksionale ka mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore dhe jo detyra konkrete në terren. Funksionet e SHPP-së në asnjë rast nuk mbivendosen me detyrat e AKP-së dhe për më tepër që këto funksione që do të kryen si në bashkëpunim me njësitë e

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

vetqeverisjes vendore ashtu edhe me institucionet qendrore, institucionet kërkimore e shkencore apo organizatat ndërkombëtare.

Ministria e Financave është shprehur dakord me vërejtje ku parë në këndvështrimin buxhetor vlerëson se projektakti shoqërohet me kosto financiare shtesë të paparashikuara për buxhetin e shtetit, si për kapitalin fillestar, ashtu edhe për kostot që lidhen me funksionalizimin e shoqërisë.

Për këtë qëllim kërkon që të paraqiten përlllogaritjet e kapitalit fillestar prej 50 milion lekësh, të detajuar sipas zërave të shpenzimeve. Gjithashtu, kërkohet të sqarohet përse këto fonde janë të lira në buxhetin e programit “Administrimi i pyjeve”, dhe ku janë parashikuar saktësisht këto fonde në këtë buxhet, pasi sipas PBA-së 2026-2028 dhe ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2026, kjo politikë e re nuk është diskutuar dhe për rrjedhojë nuk është miratuar në këto tavane.

Gjithashtu Ministria e Financave ka parashtruar dhe komente për përmbajtjen e projektligjit, për të cilat sqarojmë se projektligji është ripunuar në tërësi duke mbajtur në konsideratë komentet e Ministrisë së Drejtësisë dhe ato të Ministrisë së Financave. Për rrjedhojë edhe relacioni shoqërues është ripunuar në funksion të përmbajtjes së projektligjit të rishikuar duke ezauruar të gjitha komentet e parashtruara nga Ministria e Financave, qoftë për rishikimin e burimeve të financimit, ashtu edhe përsa i përket periudhës tranzitore apo autonomisë së pushtetit vendor.

Me Vendimin nr.5. datë 23.4.2026 të Këshillit Konsultativ të Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) është propozuar që:

Të qartësohet roli i njësive të qeverisjes vendore, duke qenë se ligji nuk përcakton qartë kompetencat e bashkive dhe strukturave vendore të pyjeve, duke krijuar hapsirë për centralizim të vendimmarrjes;

Të krijohet një model bashkëmenaxhimi midis SHSHP dhe bashkive, ku administrimi i pyjeve brenda territorit bashkiak të mos realizohet pa marrëveshje me bashkitë, dhe ku bashkitë të ruajnë rol aktiv në planifikim dhe kontroll;

Të qartësohet statusi i strukturave ekzistuese vendore të pyjeve (strukturat përgjegjëse për pyjet) nëse ato do të integrohen apo si do të bashkëpunojnë me strukturën e re apo do të vazhdojnë të funksionojnë pranë bashkive, duke garantuar që kapacitetet aktuale, si dhe të saktësohet me dispozitave më të qarta për bashkëpunim të detyrueshëm ndërmjet SHSHP, bashkive dhe strukturave të

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

emergjencave civile, përfshirë krijimin e komandave të përbashkëta në nivel lokal gjatë sezonit të zjarreve;

Për "Funksionin e shoqërisë", mbi zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet: duhet

Mospërcaktimi i qartë i pasurisë pyjore (bazuar në funksionet e shoqërisë) që do të jetë në administrim/menaxhim të SHSHP, krijon përplasje lidhur me kompetencën ekskluzive të NJVV-ve, për administrimin, menaxhimin e pasurive pyjore që ato kanë në përgjegjësi administrimi ose në pronësi sipas listave të inventarit të miratuara, kompetencë e cila u njihet këtyre të fundit sipas Ligjit 57/2020 "Për Pyjet", i ndryshuar neni 12, pika 3, neni 12, pika b, neni 16, pika, si dhe neni 17 i të njëjtit ligj. Në Ligjin 10120/2009 "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore", i ndryshuar parashikohen kompetencat e bashkive, për menaxhimin e administrimin e bimëve të kategorive të përcaktuara që bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosore në pronësi/administrim të bashkive;

Për shërbimet në ekosistem, përfshirë edhe elemente të Konventës së Peizazheve, si dhe organet drejtuese (këshilli mbikqyrës) duhet të jenë më gjithëpërfshirëse, jo vetëm politike dhe statusi juridik (tregtar) rezikon komercializimin e sektorit pa menduar për pasojat afatgjata mjedisore (psh në rast të kërkesave të larta në tregun lokal apo global për një produkt apo shërbim të caktuar mund të çojë në degradimin e tij;

Në parashikimin e të drejtës së SHSHP "për parandalimin dhe luftimin e zjarreve në pyje", nderkohe që është në misionin dhe fushën e përgjegjësisë së Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Teritorit, njësia përgjegjëse për inspektimin në pyje mbrojtja dhe kontrolli nëpërmjet inspektimit dhe imponimit të sanksioneve administrative, me gëllim parandalimin e paligjshmërive në pyje, si dhe të fusha e veprimatrise duhet shtuar edhe... mbrojtja e pyjeve nga sëmundjet e dëmtuesit edhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike;

Komercializimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, si dhe të ketë një protokoll të qartë se si do të financohen këto ndërhyrje dhe nëse do të paguajë ShShP-ja bashkitë për shërbimin e zjarfikësve kur digjen pyjet në administrim të shoqërisë;

Të përcaktohet një ndarje më e qartë se cilat asete pyjore do të mbeten nën administrimin e bashkisë (asete të regjistruara tashmë në Agjencinë Shtetërore

Relacion shpjegues për projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a."

të Kadastrës në emër të bashkive) dhe cilat do ti kalojnë shoqërisë. Pa një ndarje fizike dhe ligjore të gjatë, do të kemi konflikte në terren për dhënien e lejeve të shfrytëzimit apo menaxhimit të kullotave;

Të ketë në Këshillin Mbikëqyrës përfaqësues direkt të bashkive ose një rotacion mes kryetarëve të bashkive që kanë sipërfaget më të mëdha pyjore;

Bashkëveprimi ndërinstitucional, të percaktohet roli i MBZHR, si institucioni kryesor për politikën dhe mbështetjen e zhvillimit rural në vend, si dhe projektligji parashikon bashkëpunimin e ndërmarrjes shtetërore për pyjet me organe si; Ministrinë e Mjedisit, Agjensinë Kombëtare të Mjedisit, Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, NJVV-ve si dhe institucione akademike e shkencore, por në asnjë pikë të këtij neni nuk parashikon detyrimin e ndërmarrjes për bashkëpunim me IKMT si organi qëndror me funksione kontrolli dhe inspektimi që ka për kompetencë garantimin e zbatimit të ligjeve sektoriale në fushën e mbrojtjes së pyjeve nga ndërhyrjet e paligjshme të çdo lloji;

Të qartësohet arkitektura e qeverisjes së organeve drejtuese sepse ekziston rreziku i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë politike në vendime operative duke cënuar eficiencën, kufiri ndërmjet politikeberjes dhe menaxhimit operacional dhe në Këshillin Mbikëqyrës duhet të ketë dhe përfaqësues nga pushteti vendor; Të percaktohen mekanizmat e matjes së performancës;

Të percaktohen frekuenca të detyrueshme raportimi, të vendosen standarde të aksesit publik (open data), si dhe mekanizmat e monitorimit nga publiku;

Të specifikohet me qartë si dhe të ndalohet ndërhyrja direkte e ministrisë në operacione ditore:

- funksionin politik (Ministria);*
- funksionin strategjik (Këshilli);*
- funksionin ekzekutiv (Administratori).*

Të shtohet një nen që detyron hartimin e indikatorëve në lidhje me sistemin e performancës si, bilanci kadastral pozitiv (më shumë rritje pyjesh se sa pakësim); % e sipërfaqes së rryllëzuar në vit; ulja e zjarreve në pyje; menaxhimi i sëmundjeve dhe dëmtuesëve; etj.

Të shtohet një dispozitë që vendos prioritet absolut ruajtjen e qëndrueshme mjedisore mbi fitimin financiar, ku të percaktohen: kufij të shfrytëzimit vjetor

(sipas planeve ekologjike); auditim mjedisor i detyrueshëm; zbatim i standardeve të BE-se (EUDR, FLEGT, EIONET etj.

Të detyrohet SHSHP për konsultim me bashkitë për planet e menaxhimit, përfshirje e tyre në vendimmarrje territoriale dhe përfaqësim të interesit të komuniteteve lokale.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të komenteve të ardhura me Vendimin nr. 5, datë 23.4.2026, i Këshillit Konsultativ të AMVV-së shprehem se pjesa më e madhe e tyre u reflektua gjatë procesit të ripunimit të projektligjit "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve", nga ku u saktësua roli i organeve të vetëqeverisjes vendore dhe statusi i strukturave ekzistuese, ndarja e qartë e funksioneve dhe kompetencave të sh.a -së së pyjeve, veprimtarite si dhe bashkëveprimin ndërvendor. Në këtë kuptim, të gjitha pikat e ngritura nga AMVV janë ezauruar me ripunimin e projektligjit.

Në takimin e zhvilluar më datë 21.5.2026, në ambientet e Ministrisë dhe në praninë e ministrit përgjegjës për pyjet, u zhvillua një diskutim i gjerë me aktorë të fushës si Shoqata e Specialistëve të Pyjeve, Fakulteti i Shkencave Pyjore dhe përfaqësues të tjerë, lidhur me draftligjin për krijimin e Shërbimit të Shtetit për Shërbimet Pyjore. Pavarësisht se gjatë procesit të konsultimit ishin shprehur shumë komente dhe mosdakordësi rreth mënyrës së ngritjes së SHSHP-së, funksionit dhe aktivitetit të saj ekonomik, organizimit institucional të shërbimit pyjor, infrastrukturës, pronësisë, administrimit dhe menaxhimit të tyre, këto vërejtje u morën në konsideratë dhe u riformuluan në mënyrë të përshtatshme, duke gjetur shterim dhe zgjidhje në draftligjin e përmirësuar.

Referuar komenteve të adresuara në faqene konsultimit publik:

Zoti Leonidha Peri ka dhënë komente sidomos mbi çështjet që kanë të bëjnë me faunen, gjuetinë apo ..., ku sqarojmë se kjo nuk është një çështje që mund të konsiderohet për t'u reflektuar, pasi projektligji nuk synon të rregullojë sistemin e gjuetisë apo menaxhimin e faunës. Kompetencat mbi faunën dhe gjuetinë vazhdojnë të mbeten të rregulluara nga legjislacioni përkatës dhe institucionet përgjegjëse. Projektligji nuk i ka transferuar këto funksione tek SHSHP.

Po këtu lidhur me komentet mbi organizimin institucional, i inventarizimit kombëtar jashtë funksioneve të SHSHP; debati i përgjithshëm mbi modelin kombëtar të qeverisjes së pyjeve dhe çështjet teknike të terminologjisë pyjore,

Relacion shpjegues për projektligjin "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a."

janë elemente që rregullohen nga Ligji për Pyjet dhe jo nga ligji organizativ i SHSHP.

Një pjesë e vërejtjeve janë marrë në konsideratë në procesin e rishikimit të projektligjit, ndërsa një pjesë tjetër lidhen me politika sektoriale dhe organizimin institucional të sektorit, të cilat tejkalojnë objektin e projektligjit për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Projektligji nuk synon të ndryshojë kuadrin ligjor që rregullon biodiversitetin, pyjet, faunën e egër, gjuetinë, zonat e mbrojtura, kullotat apo instrumentet kombëtare të monitorimit dhe inventarizimit të pyjeve, të cilat vazhdojnë të rregullohen nga legjislacioni sektorial në fuqi.

Në këtë kuadër, janë reflektuar komentet që lidhen me nevojën për ndarjen e funksioneve publike nga aktiviteti operativ i shoqërisë, duke mos përfshirë më Inventarizimin Kombëtar të Pyjeve dhe monitorimin kombëtar të pyjeve ndër funksionet e SHSHP-së. Po ashtu janë forcuar dispozitat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e ekosistemeve pyjore dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet akademike e kërkimore.

Sa i përket komenteve për bashkimin e institucioneve pyjore dhe të zonave të mbrojtura, administrimin e kullotave, modelin e organizimit institucional apo analizat mbi fizibilitetin ekonomik të reformës, këto janë konsideruar si çështje të rëndësishme për diskutimin e politikave publike, por nuk kërkojnë domosdoshmërisht ndryshime në dispozitat e projektligjit, i cili ka objekt të kufizuar krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Referuar komenteve të adresuara nga z.Genci Kacorri, sqarojmë se janë shqyrtuar me vëmendje dhe kanë kontribuar në përmirësimin e projektligjit. Një pjesë e tyre janë reflektuar në tekstin e ripunuar, ndërsa një pjesë tjetër lidhen me çështje që rregullohen nga legjislacioni sektorial në fuqi ose me zgjedhje të politikave publike që tejkalojnë objektin e këtij projektligji.

Projektligji ka si objekt krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve si shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror dhe nuk synon të zëvendësojë apo ndryshojë kuadrin bazë të menaxhimit të pyjeve, biodiversitetit, faunës së egër, gjuetisë, zonave të mbrojtura apo instrumenteve teknike të planifikimit pyjor, të cilët vazhdojnë të rregullohen nga legjislacioni sektorial në fuqi.

Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë komentet që lidhen me ndarjen e funksioneve publike nga ato operationale. Për këtë arsye, në variantin e ripunuar nuk janë përfshirë ndër funksionet e Shoqërisë, Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve dhe monitorimi kombëtar i pyjeve, duke ruajtur karakterin

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

publik të këtyre funksioneve dhe duke shmangur mbivendosjen ndërmjet rolit të shoqërisë dhe funksioneve shtetërore të politikëbërjes dhe monitorimit.

Lidhur me komentet për faunën e egër, gjuetinë dhe administrimin e zonave të gjuetisë, vlerësohet se këto çështje nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i këtij projektligji. Projektligji nuk transferon tek Shoqëria Shtetërore e Pyjeve kompetenca që lidhen me menaxhimin e faunës së egër apo gjuetinë dhe për këtë arsye nuk janë parashikuar dispozita të veçanta në këtë drejtim. Këto fusha vijnë të rregullohen nga legjislacioni përkatës dhe nga institucionet kompetente.

Gjithashtu janë vlerësuar komentet lidhur me biodiversitetin, rolin e bashkive dhe nevojën për bashkëpunim institucional. Në variantin e ripunuar janë forcuar objektivat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit pyjor, mbrojtjen dhe rehabilitimin e ekosistemeve pyjore, ruajtjen e aseteve natyrore pyjore, si dhe janë parashikuar mekanizma bashkëpunimi ndërmjet Shoqërisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, si edhe me institucionet akademike e kërkimore.

Pjesa tjetër e komenteve lidhet kryesisht me vlerësime mbi modelin e propozuar organizativ, fizibilitetin ekonomik, nivelin e investimeve të nevojshme, potencialin e shfrytëzimit të fondit pyjor, krahasimet me modele ndërkombëtare apo alternativa të tjera të organizimit institucional. Këto vlerësime janë konsideruar të vlefshme për diskutimin e politikave publike në sektor, por nuk kërkojnë domosdoshmërisht ndryshime në dispozitat normative të projektligjit, i cili përcakton vetëm bazën juridike për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Në përfundim, vlerësojmë se komentet kanë ndihmuar në qartësimin e rolit të Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve dhe në përcaktimin më të saktë të funksioneve të saj, duke ruajtur ndarjen ndërmjet kompetencave shtetërore rregullatore dhe funksioneve operacionale të shoqërisë, si dhe duke siguruar vijimësinë e zbatimit të legjislacionit sektorial në fuqi për pyjet, biodiversitetin, faunën dhe mjedisin.

Referuar komenteve të ardhura nga Universiteti Bujqësor, sqarojmë se:

Lidhur me propozimin për bashkimin e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe zonat e mbrojtura, vlerësojmë se kjo çështje lidhet me organizimin institucional të administratës publike dhe nuk përbën objekt të drejtpërdrejtë të këtij projektligji, i cili synon vetëm krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”

Sa i përket centralizimit të menaxhimit të fondit pyjor, komentet janë marrë në konsideratë. Projektligji synon forcimin e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve në nivel kombëtar, duke ruajtur njëkohësisht mekanizma bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të parashikuara në tekstin e tij.

-Lidhur me kullotat, sqarojmë se projektligji fokusohet në fondin pyjor dhe funksionet e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, ndërsa çështjet që lidhen me administrimin e kullotave trajtohen në kuadër të legjislacionit dhe politikave sektoriale përkatëse.

Në përfundim, sugjerimet për rritjen e transparencës dhe përfshirjen sa më të gjerë të aktorëve të sektorit janë vlerësuar pozitivisht dhe do të mbahen parasysh në vijim të procesit të diskutimit dhe konsultimit të projektligjit.

Zoti Abdulla Diku ka mirëpritur nismën për krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve pasi përbën një mundësi reale për të korrigjuar problematikat e krijuara nga modeli aktual i administrimit të pyjeve. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen kritike të fondit pyjor në vend dhe pasojat afatgjata që mund të sjellë çdo vendimmarrje e gabuar në këtë sektor, shprehet se modeli i propozuar duhet të mbështetet në një analizë më të thelluar të situatës ekzistuese, në një proces të gjerë konsultimi me ekspertizën akademike, profesionale dhe institucionale, si dhe në një arkitekturë qeverisëse të qartë, transparente dhe të balancuar. Në veçanti, është e rëndësishme të garantohet se qëndrueshmëria ekologjike e pyjeve mbetet prioritet mbi objektivat ekonomike, të qartësohen mekanizmat e llogaridhënies dhe matjes së performancës, të sigurohet përfaqësimi i komuniteteve lokale dhe ekspertizës së pavarur në proceset vendimmarrëse, si dhe të sqarohet ndërveprimi i modelit të ri me institucionet ekzistuese dhe me detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian, përfshirë zbatimin e instrumenteve si EUDR dhe FLEGT. Për këtë arsye, do të ishte e dëshirueshme që modeli i propozuar të mbështetej në praktika të konsoliduara dhe të suksesshme të vendeve të Bashkimit Evropian, duke adoptuar në mënyrë koherente elementët institucionalë, ligjorë dhe menaxherialë që kanë dëshmuar efektivitet në administrimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Sugjerimet e mësipërme janë marrë në konsideratë gjatë ripunimit të projektligjit.

Ndoshtur në kushtet kur projektligji ka pësuar ndryshime, projektligji i ripunuar do të përcillet për bashkërendim tek të gjitha institucionet që u është përcjellë për mendim


VIII.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikohet të sjellë efekte financiare për buxhetin e shtetit që lidhen me kapitalin fillestar të SHSHP sh.a.

Kapitali fillestar për krijimin e “SHSHP”, sh.a., është **33,194,913** (*tridhjetëtre milionenjëqindenëntëdhjetëekatërmijë e nëntqinetrembëdhjetë*) lekë.

MINISTRI

Sofjan JAUPAJ



Relacion shpjegues për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a.”